




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "POSITIVE GOLD"

Nr. i biznesit - 70692031

Pronar – Mrika KOTORRI

OSHMA:

1. POSITIVE GOLD TV

2. SUITE TV

3. TRAVELINGO

Prishtinë

"POSITIVE GOLD" SH.P.K.

Nr. i biznesit - 810109761

Pronar: Astrit DUSHI

Prishtinë

Ref:1902/229/LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin e pronarit si person fizik si dhe ndryshimin e licencës së OSHMA: Positive Gold TV, Suite TV dhe Travelingo, sipas ndryshimeve në llojin e biznesit– me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Positiv Gold TV, Suite TV dhe Travelingo janë ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale të licencuara nga KPM, për transmetim të programeve televizive nëpërmjet sistemit të operatorëve të shpërndarjes, me seli në Prishtinë.

4. Me datën 28 janar 2019, KPM, ka pranuar një kërkesë nga pronarja e OSHMA: Positive God TV, Suite TV dhe Traveling, me anë të së cilës ka kërkuar ndryshimin e pronësisë, respektivisht, pronarit si person fizik, duke e kaluar pronësi nga znj. Mrika Kotorri tek z. Astrit Dushi në kuadër të llojit të ri të biznesit “Positive Gold” SH.P.K.

Arsyetim

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”*.
6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së”*
7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë.”*
8. Pronari aktual i OSHAM-ve: Positive Gold TV, Suite TV dhe Travelingo me anë të kërkesës ka deklaruar se arsyeja e ndryshimeve në pronësi është përcaktimi i sajë që të inkuadrohet në aktivitete politike.
9. Me anë të kërkesës për ndryshime në pronësi, pronari aktual ka deklaruar se ka ndryshuar llojin i biznesit nga ai individual N.SH. “Positive Gold” me numër të biznesit - 70692031, në emër të së cilit janë lëshuar licencat e OSHMA, Positive Gold TV, Suite TV dhe Travelingo, në biznes me përgjegjësi të kufizuar „Positive Gold“ Sh.p.k. me numër të biznesit - 810109761 (vazhdimsi e biznesit N.SH. „Positive Gold“).
10. Komisioni konstaton se, në bazë të vendimit për ndryshimin e statutit të „Positive Gold“ Sh.p.k. dhe në çertifikatën e regjistrimit të këtij biznesi z. Astrit Dushi figuron si pronar i vetëm.
11. Komisioni konstaton se, kandidati i propozuar për pronar të ri të OSHMA: Positive Gold, Suite TV dhe Travelingo, ka shprehur gatishmëri, që shërbimet mediale audovizuale ti ofrojë për publikn, në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
12. Kandidati për pronarë të ri ka dorëzuar një planë zhvillimor, me anë të së cilit ka përcaktuar objektivat e tij, ku ka paraparë edhe investime në teknologji dhe investime në resurse humane.
13. Kandidati për pronar të ri, si pjesë e kërkesës ka bashkangjitur edhe dëshmi nga institucionet financiare sa i përket qëndrueshmërisë financiare.

14. Komisioni vlerëson se, kërkesa është parashtruar në pajtim me procedurat e KPM-së, të bazuara në Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

VENDIM

15. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 22 shkurt 2019, merr vendim për ndryshimin e pronarit si person fizik dhe duke e kaluar pronësinë nga znj. Mrika Kotorri tek z. Astrit Dushi, në kuadër të biznesit të biznesit "Positive Gold" Sh.p.k. si dhe ndryshimin e licencave të OSHMA: Positive Gold TV, Suite TV dhe Travelingo, sipas ndryshimeve në llojin e biznesit, pra duke transferuar licencat në emër të "Positiv Gold" Sh.p.k.

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



22.02.2019

datë